



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 09.09.2015

PËR

**PËRCAKTIMIN DHE SHPALLJEN SI ZONA TË RËNDËSISË KOMBËTARE NË
PLANIFIKIM, TË 64 ZONAVE TË MBROJTURA TË MONUMENTEVE TË
KULTURËS, TË SHPALLURA ME URDHËR TË MINISTRIT TË KULTURËS,
PAS MIRATIMIT NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË RESTAURIMEVE PËR
PERIUDHËN 2014-2015**

Në mbështetje të neneve 5, 7, 9, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM Nr. 672, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, VKM-së Nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin dhe shpalljen si zona të rëndësisë kombëtare në planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me Urdhër të Ministrit të Kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015, sipas kufijve të territorit paraqitur në hartën dhe relacionin përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të jetë autoriteti përgjegjës për kontrollin e përputhshmërisë me këtë vendim, të dokumenteve të planifikimit të çdo niveli, që do të hartohen në të ardhmen në territoret e 64 zonave të mbrojtura si edhe dokumenteve të zhvillimit e ndërtimit brenda këtij territori.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, brenda 10 ditëve nga marrja e këtij vendimi, të botojë vendimin në Regjistrin e Integruar të Territorit dhe ta dërgojë atë në adresë të gjithë autoriteteve të planifikimit që ndodhen brenda territorit të 64 zonave të mbrojtura.
4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe të gjitha Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



MIRELA KUMBARO

MINISTËR I KULTURËS



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT